

SHOQËRIA E LIRË



MEDIA TË LIRA PËR SHOQËRI TË LIRË
NJUSLETER #1, SHTATOR - TETOR VITI 2017



NUK KA LIRI PA MEDIA TË LIRA

XHABIR DERALLA, CIVIL

Media të lira për shoqëri të lirë është më tepër se një projekt. Kjo është hapësirë në të cilën çdo qytetare dhe qytetar kanë mundësi të fitojnë informata dhe dituri, por edhe të kontribuojnë drejtpërsëdrejti në proceset politike dhe shoqërore. Projekti është përpiluar si hapësirë në të cilën çdo individ është pjesëmarrës i çmueshëm. Çdo kush nga ne mund të bëhet pjesë e rrjetit që vëzhgon dhe mbledh informata nga terreni, merr pjesë në krijimin e përmbajtjeve mediatike, dhe merr pjesë në evenimentet publike për forcimin e vetëdijes publike, anëmbanë vendit.

Ky është tentim unik për bashkimin e qytetareve dhe qytetarëve rreth idesë për ndërtimin e përbashkët të mediave të lira dhe shoqërisë së lirë. Shumë herë është thënë se mediat e luajnë rolin esencial në zhvillimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ka ardhur koha që këtë edhe me të vërtetë ta bëjmë. Më në fund, u nisëm drejt krijimit të një resursi, njëkohësisht qytetar dhe mediatik për zhvillimin e shoqërisë mendjelirë në të cilën jetojnë njerëz të barabartë dhe në të cilën zëri dhe mendimi i çdo njeriu e fiton vendin e vet të rëndësishëm dhe të merituar. Me këtë projekt, Civilit do të jep kontributin e vet në më tepër fusha komplekse në periudhën e rëndë të tranzicionit dhe demokratizimit. Me ekip me përvojë, të kalitur gjatë vitetve të sfidave, do të krijohet dhe artikullohet hapësirë e lirë për këmbim dinamik të informatave, qëndrimeve dhe analizave, të cilat do ti ofrohen opinionit dhe institucioneve.

Njëkohësisht, projekti do të kontribuojë shumë për dialogun politik dhe shoqëror, forcimin e lirisë së shprehjes, dhe shkrim-leximin mediatik të

qytetareve dhe qytetarëve. Kultura politike do të pasurohet me përmbajtje për edukimin qytetar dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke e përfshirë edhe të drejtën votuese.

Mediat e lira janë parakushti themelor për shoqëri të lirë, ashtu si vetëm shoqëria e lirë mundet të krijojë hapësirë mediatike në të cilin informata dhe qëndrimet janë të lira nga korrupsioni dhe presionet që i imponojnë qendrat e fuqisë. Në ato dy drejtime - çlirimi dhe dekontamini i hapësirës mediatike, dhe inkurajimi i qytetareve dhe qytetarëve të ndërtojnë shoqëri të lirë, Civilit do ta zbatojë këtë projekt kompleks dhe dinamik. Ky është edhe një projekt në të cilin do të pasqyrohet karakteri i Civilit, që do të jetë aktiv ditë e natë dhe do të krijojë platformë plotësisht të pavarur e cila do të shërben si resurs publik për mediat, organizatat qytetare, dhe të gjithë qytetarët aktivë të cilët e kuptojnë dhe e mbështesin këtë koncept.

Ekipi i Civilit veç më punon në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve nga I tërë vendi, ndërsa sipas planit të implementimit, do të bëjë 88 evenimente më të vogla dhe më të mëdha, dhe aktivitete në terren, duke mos e llogaritur prodhimin e përditshëm mediatik.

Shkurtë, na presin ditë dhe muaj plotë me aktivitete në të cilat çdo njeri nga ne është i ftuar ta jep kontributin e vet. Ne jemi krenarë për arritjet tona, por do të japim çdo gjë nga vetja që ti tejkalojmë të gjitha pritjet.

Bashkohuni me ne!

Projekti i ri i Civilit është kontribut unik për ndërtimin e mediave të lira dhe shoqërisë së lirë.

BËHU PJESË E EKITIT TË CIVILIT

Dëshironi të veproni si qytetare dhe qytetarë të lirë? Doni të ndikoni në opinionin publik dhe proceset reformiste nga pozita objektive dhe e pavarur? Nuk dëshironi të ngecni në kuazi - organizatë burokratike dhe mashtruese? Doni të jeni përgjegjës dhe të dobishëm për shoqërinë? Jeni në kërkim të shkathtësive të reja? Keni nevojë dhe dëshirë të kontribuoni për kthimin dhe ndërtimin e demokracisë në Republikën e Maqedonisë?

Përgjigja jonë është e thjeshtë: **Bëhu CIVIL!**

Pjesë e aktiviteteve të Civilit në këtë periudhë është vëzhgimi afatgjatë i proceseve politike dhe gjendjeve të të drejtave të njeriut, dhe promovimi i projekteve në fushën e zgjedhjeve, mediave, drejtësisë sociale, pjesëmarrjes qytetare, shoqërisë së qëndrueshme dhe kontrollit të armëve. Organizata për çdo ditë i boton gjetjet, analizat dhe rekomandimet e veta përmes platformës mediatike të CIVIL Media, edhe atë në www.civilmedia.mk në gjuhë maqedonase, www.drejt.mk ose www.civilalb.mk (në gjuhë shqipe), dhe në një varg ueb faqesh të specializuara në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Më tepër për organizatën mund të kuptohet në ueb faqen e organizatës në: www.civil.org.mk.

Civili ka nevojë për njerëz të gjithanshëm, aktivë dhe objektivë, me përvojë në ndonjë nga fushat: vëzhgim i zgjedhjeve ose ndjekje e gjendjes të së drejtave dhe lirive të njeriut, gazetari, hulumtim dhe marrëdhënie me publikun. Të gjithë janë të mirë-seardhur. Nuk ka kufizime nga mosha, gjinia, përgatitja profesionale – shkurt, nuk ka kufizime mbi asnjë bazë, ndërsa nuk është i kufizuar as numri i bashkëpunëtorëve.

Për çdo raport të botuar të bashkëpunëtorëve/ raportuesve të Civilit, gjegjësisht CIVIL Media, do të jepet honorar prej 100 denarë bruto. Civilit do të organizojë trajnime për gazetari dhe vëzhgim për kandidatët për pozita honorariste, si dhe për vullnetarët, mbështetësit dhe anëtarët e vet. Qytetet dhe terminet në të cilat do të mbahen trajnimet, do të përcaktohen sipas numrit dhe vendbanimit të aplikuesve. Shpenzimet e rrugës për pjesëmarrje në trajnime do të mbulohen nga Civilit. Punëtoritë do të mbahen në gjysmën e parë të muajit shtator.

CIVILI i fton të gjithë qytetaret dhe qytetarët të kyçen në organizatë me Deklaratë për mbështetje, ndërsa, nëse kanë dëshirë për pozitë vullnetare ose honorariste në projektet e Civilit, duhet të dërgojnë biografi të shkurtë (maks. 1 faqe) dhe letër motivimi (maks. 150 fjalë). Në letërën e motivimit përshkruani motivet dhe gatishmërinë për plotësimin e detyrave të punës bashkë me ekipin e Civilit, si dhe nga disa fjalë për përvojat, shkathtësitë dhe fushat

në të cilat dëshironi të keni mentorim plotësues gjatë punës. **ME RËNDËSI:** Lajmëroni Civilin kur jeni në dispozicion dhe në cilën pozitë keni dëshirë të jeni. Nëse keni qenë pjesë e ndonjë seminari ose aktiviteti tjetër të Civilit, ndërsa nuk e keni plotësuar Deklaratën për mbështetje, paraqiteni kohën dhe vendin e këtij aktiviteti në letërën e motivimit. Do të shqyrtohen vetëm aplikimet që do të arrijnë përmes postës elektronike E-mail: desk@civil.org.mk.

Afati i fundit për aplikimin në këtë fazë është më 15 gusht. Do të shqyrtohen vetëm aplikimet e arritura me postë elektronike. E-mail: desk@civil.org.mk. Nëse nuk merrni përgjigje kthyesë se aplikimi ka arritur, ju lutemi lajmërohuni në 02/5209176 ose na shkruani mesazh në FB faqen tonë.

Një pjesë e madhe e angazhimit të Civilëve përbëhet nga: vëzhgime, hetime, analiza, produksion i përmbajtjeve mediatike në pajtim me projektet dhe dokumentet themelore të Civilit; aktivizëm dhe edukim qytetar; paraqitja e Civilit në opinion: vëzhgimi dhe komunikimi me institucionet, partitë politike, shoqërinë qytetare, bashkësinë ndërkombëtare etj. Për çdo ditë prodhohen lajme, analiza, intervista, reportazhe etj. Përmbajtjet publikohen në të gjitha formatet (video, foto, audio dhe tekst) në më tepër ueb faqe dhe në rrjetet sociale.

Menjëherë t’u përgjigjemi të interesuarve të cilët nuk jetojnë në Shkup: Nuk është me rëndësi se ku jeton. Me rëndësi është të jesh CIVIL. Ne jemi organizatë nacionale, vazhdimisht prezente anembanë Maqedonisë, dhe atje jeni të nevojshëm pikërisht Nuk keni dijeni, përvojë dhe shkathtësi të mjaftueshme? Kjo nuk paraqet problem. Ineresimi dhe përkushtimi për ne janë më të rëndësishmet. CIVIL është vend ku mësohet. Pajisja që e kemi, do të jetë në dispozicion për mësim dhe trajnim, por edhe për avancim të shkathtësive të arritura.

Mos harro: paraqitu, bisedo me ndonjë anëtar të ekipit të Civilit, dhe kuptohet, pëlqe Fejsbuk faqen e Civilit. **Bëhu CIVIL!**



SASHO ORDANOSKI

Drama nëpër të cilën po kalon LSDM tre muaj pas formimit të Qeverisë, është dramë e politikës së tyre kadrovike. Disa njerëz të mençur kanë thënë se në politikë edhe nuk ka diçka tjetër përveç, në fakt, politikës së personelit, sepse, me çfarë njerëz do të rrethohesh, ashtu edhe do të mbarosh. Pas njëqind ditë në pushtet, pakënaqësia nga politika e personelit, të cilën nëpër negociatën të ndërsjellë, e udhëheqin Zaevi dhe Shekerinska (e pastaj edhe me tërë kakovinë qeverisëse), është e madhe: partia u digjet në eshalone të ndryshme, opinionin po zbavitet ose iritohet me zgjidhje kadrovike“nga e para- në rikverc”, në vende të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme, nëpër sektore të tëra (për shembull në shëndetësi), dëshpërimi është ndjenjë pothuajse dëshpëruese, ndërsa me qindra motorë të regjimit të Gruevskit, tani të liruar nga mobingu i vazhdueshëm psikologjik dhe kriminel para të cilit ishin të ekspozuar për një dekadë të tërë nga VMRO – partia e tyre, akoma janë rehatshëm të ulur nëpër ulëse të ndryshme shtetërore, mbi të cilat vendosin për para, politika, udhëtime zyrtare dhe angazhime pune... Për bukuri!

Mbi të gjitha, tani arrijnë edhe listat e kandidatëve për kryetarë komunash dhe këshilltarë për zgjedhjet vendore, të cilat çdo herë dhe në çdo parti kanë qenë rast i jashtëzakonshëm për luftë brendapartiake, e të cilat LSDM edhe kësaj here si duket do t’i krijojë sipas modelit të Gruevskit: Si të thotë babi (dhe mami!) – që do të thotë se anëtarësia dhe parimi i meritave dhe kualifikacioneve të punës do të pyeten më pak, ndërsa më tepër – interesi i fraksionit në udhëheqësinë e partisë. Hmmm... Vetëm t’u përkujtoj se procesi i “buzlevizimit” i LSDM në fund të viteve të nëntëdhjeta, nën udhëheqësinë e Cërvenkovskit, i shkaktoi partisë humbje katastrofike në zgjedhjet

DRAMË NË LSDM

TEKSTI MË I LEXUAR I BOTUAR NË CIVIL NË PERIUdhËN nga fillimi i PROJEKTIT (15 KORRIK) DERI MË 20 SHTATOR



e vitit 1998, humbje nga e cila social – demokratët (edhe Maqedonia) deri në ditën e sotme nuk mund të marrin veten në tërësi.

Për shembull, mua nuk më hyn në kokë se si bëhet që një mekanizëm politik – partiak si LSDM, vetëm disa javë para zgjedhjeve, të mos dijë se cili është kandidati i tyre për kryetar të Shkupit?! ...Ky person duhet të dihet së paku me muaj, nëse jo edhe me vita para, veçanërisht për një parti e cila asnjëherë, pas pavarësimit e deri tani, nuk ka qeverisur me kryeqytetin e shtetit (ose ndoshta pikërisht për këtë arsye)! Vizionet personale, politike, kulturore, të biznesit, dhe vizione tjera, dhe lidhjet e kandidatit për kryetar të Shkupit, qoftë grua ose burrë, janë çështje për të cilën qytetarët e ulësës kryesore të shtetit, kanë të drejtë të dinë shumë më herët se njëzet ditë në një “mule- gutu” fushatë zgjedhore. Ja pra, te VMRO, ai kandidat përsëri është “hausmajstori” i shtëpisë – Koce, dhe nuk ka njeri nga Shkupi i cili nuk ka mendim të formuar – Koce, nëse pyetem unë, ai mund ta qëndrojë në shtëpi gjatë tërë fushatës zgjedhore, sepse mendja e tij dhe perimetri – lopatë janë të njohura deri në imtë-sira të dhimbshme. Kështu, ne vend se të merremi me botëkuptime eventuale qytetare të kandidatit të LSDM për kryetar të Qytetit të Shkupit, opinionin do ta kalojë tërë fushatën zgjedhore në ndeshje të pista nëpër rrjetet sociale, duke spekuluar për kuzhinat brendapartiake në partinë qeverisëse. Këtë film të ligë në LSDM e shohim tridhjetë vite me radhë.

Kjo më përkujton në barçoletën me rabinin çifut, kur e kanë pyetur se si është gjendja në vendin e tyre? “Gud!”, thotë rabini. E, a mund të na tregoni më hollësisht? “Not gud!” ... Kështu disi edhe me LSDM-në.

CIVIL Media – hapësirë për qëndrime të ndryshme dhe stacion i rregullt për informimin e qindra mijëra qytetareve dhe qytetarëve

CIVIL Media është njësi organizate e CIVIL -Qendrës për Liri. Në kornizat e saja, funksionon redaksia me gazetarë dhe gazetarë profesionistë, por edhe fillestarë që kanë vendosur që përgatitjen e tyre ta mbindërtojnë me punë praktike gazetarë-hulumtuese.

Ueb faqja www.civilmedia.mk është një nga përmbajtjet më të dukshme të projektit Media të lira për shoqëri të lirë. Është e specializuar për politikë, shoqëri dhe kulturë. Për çdo ditë, ekipi i projektit prodhon së paku dhjetë përmbajtje autoriale në format tekstual ose video. Para zgjedhjeve lokale, kjo ueb faqe është resurs i veçantë publik për edukimin dhe informimin për rrjedhën e këtij procesi të rëndësishëm zgjedhor.

Sllogani i kësaj ueb faqeje është: LIRSHËM, PAVARUR, HAPUR.

Çdo ditë tentojmë ta arsyetojmë këtë slogan me botimin e informatave objektive dhe në mënyrë të hapur dhe konstruktive e kritikojmë çdo dukuri në shoqëri. Në rubrikën MENDIMI, pothuajse

çdo ditë publikohen qëndrime dhe mendime të intelektualëve të lartë, ekspertëve dhe aktivistëve. Qëndrimet e tyre jo çdo herë janë në pajtim me qëndrimet e Civilit ose të donatorëve të organizatës, mirëpo janë hapësirë e rëndësishme përmes cilës ne angazhohemi për forcimin e kulturës dhe dialogut politik.

Në periudhën e kaluar kjo ueb faqe u bë stacion i rëndësishëm në të cilin qindra mijëra qytetarë dhe qytetarë për çdo ditë informohen për ngjarje të rëndësishme për proceset shoqërore – politike dhe për qëndrimet e ndryshme të kolumnistëve dhe analistëve tonë.

Përmbajtjet e publikuara në këtë ueb faqe janë të lira për marrje, sipas licencës Creative Commons, që do të thotë se mund të publikohen edhe në media tjera, me kusht që të paraqitet autorja/autor dhe burimi (me link), si dhe disklejmer në të cilin paraqiten të dhënat themelore të burimit dhe projektit.

www.civil.org.mk
www.civilmedia.mk
www.civilalb.info
www.civil.today

www.youtube.com/c/CivilMacedonia
www.youtube.com/user/CivilOrgMK
www.facebook.com/civil.mk
www.facebook.com/citizen.journalists.mk
www.facebook.com/sezaizbori
www.facebook.com/socijalna.pravda.drejtesi.sociale
www.facebook.com/FreedomCaravan
www.facebook.com/speak.up.mk
www.twitter.com/CivilMacedonia
www.twitter.com/Slobodnilzbori
www.twitter.com/BeFreeMK
www.soundcloud.com/civil-org-mk

PARAQITNI:

- Shkelje të të drejtave të njeriut
- Shkelje të drejtës votuese
- Parregullsi zgjedhore
- Mobing dhe presione politike
- Keqpërdorim të resurseve publike

Paraqituni në: 02/5209176
www.facebook.com/civil.mk
civil@civil.org.mk

Për Civilin

CIVIL –Qendra për Liri është shoqatë nacionale qytetare jopërfutuese në fushën e të drejtave të njeriut, paqe dhe kontrollit të armëve, e themeluar më 25 nëntor të vitit 1990. Joformalisht, organizata është aktive nga viti 1996.

Vëzhgimi zgjedhor zbatohet nga viti 2008, duke vendosur metodologji të me efektivitet të lartë të vëzhgimit dhe edukimit qytetar për të drejtat votuese.

Në kërkim të vizionit të vet, misioni i Civilit është: promovimi aktiv dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut; paqes së qëndrueshme dhe proceset e pajtimit; krijimit të planeve për kontrollin efektiv të armëve; drejtësi sociale dhe liria e shprehjes.

Civili është aktiv në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, dhe ka zbatuar mbi 100 projekte, duke i përfshirë edhe fushatat për ngritjen e vetëdijes nacionale, evenimente të mëdha publike, etj. Organizata gëzon dukshmëri të madhe dhe besim nga të gjitha bashkësitë në vend.

Projekti Media të lira për Shoqëri të lirë është i financuar nga Ministria Federale për punë të jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë.

Këtë botim e përgatiti ekipi i projektit të CIVIL -Qendrës për Liri. Personi përgjegjës; Xhabir Deralla. Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe autorëve të teksteve dhe nuk i pasqyrojnë çdo herë qëndrimet e donatorëve.

www.clp.mk
www.freedom.mk
www.greencivil.mk
www.slobodnilzbori.info
www.zgjedhjetelira.info
www.freeelections.info